



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.62/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e [REDACTED] nga Komuna e Prishtinës, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mosrealizimit të votimit nga ekipa mobile për personat me nevoja të veçanta, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 31.12.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa, ZP.Anr.62/2025 e datës 30.12.2025, parashtruar nga [REDACTED] nga Komuna e Prishtinës, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mosrealizimit të votimit nga ekipa mobile për personat me nevoja të veçanta, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me 30.12.2025 PZAP- i, ka pranuar ankesë ZP. Anr.62/2025, nga [REDACTED] Komuna Prishtinë, aplikimi për person që nuk mund të dal nga shtëpia (aktualisht i operuar), është bërë brenda afatit ligjor dhe kjo kërkesë është shqyrtuar dhe aprovuar nga KQZ. Tutje në ankesë theksohet se në ditën e zgjedhjeve, nuk është paraqitur asnjë ekip edhe pas thirrjeve të realizuara nga ana e jonë në numrin kontaktues 080055555 (thirrje këto të realizuara para afatit të mbylljes së votimeve 19:00 hrs. Parashtruesi në ankesë konsideron se kjo është shkelje që e dëmton procesin dhe besueshmërinë e qytetarit ndaj institucioneve, respektivisht KQZ-së. Parashtruesi i ankesë ka bashkangjitur kopjen e formës së aprovuar të aplikimit si dhe thirrjet kundrejt KQZ-së.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se në përputhje me nenin 99 të Ligjit Nr. 08/228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 2, nenin 5 dhe nenin 9 të Rregullores Zgjedhore Nr. 09/2024 për Regjistrimin dhe Votimin e Personave me Nevoja të Veçanta, përcaktohet e drejta dhe procedura për realizimin e votimit për këtë kategori të

votuesve. Pas pranimit të kërkesës nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), KQZ ka kontaktuar Zyrtarin Ekzekutiv të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (ZEKKZ) në Komunën e Prishtinës, me qëllim që të njoftohet për rastin konkret ZEKKZ, për rastin në fjalë ka njoftuar si në vijim: "Votuesja në fjalë është kontaktuar nga ekipi për t'i mundësuar votimin në shtëpi, Megjithatë, përgjigjja e marrë nga kontakti ka qenë se votuesja ndodhej në lagjen 92 në Fushë Kosovë. Lidhur me këtë rast, ekipi ka kontaktuar Komisionin Komunal të Zgjedhjeve, *Unë personalisht i kam njoftuar se rasti bie në kompetencë territoriale të Komunës së Fushë Kosovës*". Bazuar në sqarimet e mësipërme të ZEKKZ në Prishtinë, rezulton se pamundësia për realizimin e votimit nuk ka ardhur si pasojë e mosveprimit të KQZ-së, apo organeve vartëse të saj, por për shkak se votuesja ndodhej jashtë juridiksionit territorial të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Prishtinë. Të bashkangjitur ju dërgoj deklaratën e ZEKKZ në Prishtinë. Për rastin në fjalë, ekipa e VPNV deklaron: *Votuesja në fjalë është kontaktuar nga ekipa për t'i mundësuar votimin në shtëpi, por përgjigjen që e kane marr nga ky kontakt ka qenë, gjendemi në lagjen 92 në Fushë Kosovë. Ekipa kane kontaktuar KKZ rreth rastit, Unë personalisht ju kam thënë se është kompetencë territoriale e Komunës së Fushë Kosovës*. Po ashtu PZAP përmes e-maili zyrtar ka kërkuar nga KQZ, informacion lidhur me adresën e votueses me nevoja të veçanta, dhe të cilët në përgjigjen e tyre kane theksuar se votuesja është e regjistruar për votim me nevoja të veçanta në komunën e Prishtinës, lagja Bregu i Diellit, [REDAKTUAR], Prishtine.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë vëren se:

- **Ankesa është e pabazuar.**

Paneli i vlerësoj ankesën e votueses [REDAKTUAR] ku e njëjta pretendon se: edhe pse aplikimi për person që nuk mund të dal nga shtëpia (aktualisht i operuar), është shqyrtuar dhe aprovuar nga KQZ, por se në ditën e zgjedhjeve, nuk është paraqitur asnjë ekip edhe pas thirrjeve të realizuara nga ana e jonë në numrin kontaktues 080055555 (thirrje këto të realizuara para afatit të mbylljes së votimeve 19:00 hrs. Mirëpo paneli i konstatoj se të njëjtat janë të pa bazuara. Kjo pasi që paneli gjeti se bazuar në dispozitat e rregullores së KQZ për regjistrim dhe votim i personave me nevoja të veçanta nr.09/2024 me nenin 7 nën par.7.1 përcakton se pas përfundimit të procesit të regjistrimit KKZ përgatit listën e votuesve me nevoja të veçanta, me këto të dhëna emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal, adresën e shtëpisë dhe numrin e telefonit. Prandaj, KKZ e kontakton ditën e zgjedhjeve në këtë numër të telefoni dhe në adresën e dhënë nga votuesi.

PZAP përmes e-maili zyrtar ka kërkuar nga KQZ, informacion lidhur me adresën e votueses me nevoja të veçanta, dhe të cilët në përgjigjen e tyre kane theksuar se votuesja është e regjistruar për votim me nevoja të veçanta në komunën e Prishtinës, lagja Bregu i Diellit, [REDAKTUAR] Prishtine.

Nga kjo rezulton se votuesja me nevoja të veçanta ka aplikuar për të votuar duke e dhënë adresën lagja Bregu i Diellit, [REDAKTUAR], Prishtine, dhe KQZ ka përgatit listën e votuesve te kësaj kategorie për Komunën e Prishtinës, përfshirë edhe adresën

e dhënë nga votuesi, ashtu siç është përcaktuar me nenin 7 nën par.7.1 të Rregullores nr.09/2024 .

Nga përgjigja e dhënë në ankesë nga ana KQZ rezulton se ankuesja është kontaktuar ditën e votimi, por se nga përgjigja e marrë nga votuesja ka dal se ajo ndodhet në lagjen 92 në Fushë Kosovë. Në rrethana të tilla PZAP vlerëson se KQZ ka vepruar sipas rregullores në fuqi duke kontaktuar me aplikuesen- votuesen me nevoja të veçanta në adresën e dhënë në aplikacionin, përkatësisht në Komunën e Prishtinës, andaj nuk mund të konsiderohet se i është bërë e pamundur votueses për të votuar për shkak të mosveprimit të KQZ, apo organeve vartëse të saj, por për shkak se votuesja nuk ka qene ne adresën e dhënë ne aplikim.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të saj , nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZP.Anr.62/2025 datë 31.12.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Plisaj Rugova



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.